

UDC 348.9:28

Bashkim Aliu, PhD<sup>132</sup>

**MENDIMI RELIGJIOZ ISLAM NË FUNKSION TË INTEGRIMIT  
-TRADITA PROFETIKE SI SHEMBULL-**

**ИСЛАМСКОТО РЕЛИГИОЗНО МИСЛЕЊЕ ВО ФУНКЦИЈА  
НА ИНТЕГРАЦИЈАТА  
- ПРОРОКОВАТА ТРАДИЦИЈА КАКО ПРИМЕР -**

**ISLAMIC RELIGIOUS THOUGHT ABOUT INTEGRATION  
-WITH PROPHETIC TRADITION AS A KEY RESOURCE-**

---

Abstract

The text of the impact of religious thought in the integration process, referring to the second source of Islamic religion-the prophetic tradition, the source of which is the epitome of Islamic teachings. The text emphasis on the function of the second source of Islamic religion-prophetic tradition in advancing integrative Concept Muslim community, as a principle compatible with Islamic teachings, considering that in Islam there are two basic sources unanimously accepted: the revelation that is the primary source of Islam and Sunnah-prophetic tradition, which is the second source of Islamic teachings, and who is considered a practical explanation of the source view. In the teachings of this second source of Islam, there is room for investigations and comparisons, which in fact alludes to the fact that there are areas where there is room for experts of Islamic law to have their say, referring to basic resources Islamic law and

---

<sup>132</sup> Autori është doktor i studimeve evropiane për integrim. Anëtar i Unionit Botëror të Dijetarëve Muslimanë. E-mail: bashkim\_aliu@hotmail.ch

making comparisons and analogies necessary in view of issuing instructions in terms of supporting the Islamic teachings, positive integration. Hence the idea that finds support integration in the prophetic tradition, presented as the first feature and substantial support for the Muslim community integration processes in the Islamic worldview. In this respect the Charter of Medina treated as a special case of the prophetic tradition in supporting integration processes, and one of the oldest religious documents in the world of a political nature, which directly reflects the integration sphere.

**Keywords:** Religion, religious functions, integration, Islam, Prophetic Tradition, the Charter of Medina.

### Abstrakt

Teksti e trajton ndikimin e mendimit religjioz në procesin e integritetit, duke u thirrur në burimin e dytë të religjionit islam-traditën profetike, burim ky që është mishërim i mësimëve islame. Teksti ven theks në funksionin e burimit të dytë të religjionit Islam-traditës profetike në avancimin e konceptit integruar në komunitetin musliman, si parim kompatibil me mësimet islame, duke marrë parasysh se në Islam kemi dy burime bazë të pranuar me unanimitet: Kur'anin, që është burim primar në Islam, dhe Sunetin-Traditën profetike, që është burimi i dytë i mësimëve islame dhe i cili konsiderohet shpjegim praktik i burimit të parë. Në mësimet e këtij burimi të dytë të Islamit, ka hapësirë për gjurmime dhe krahasime, e që në fakt aludon në atë se ka fusha ku ka hapësirë për ekspertët të e të drejtës islame që ta thonë fjalën e tyre duke u thirrur në burimet bazike të të drejtës islame dhe duke bërë krahasime dhe analogji të nevojshme në funksion të nxjerrjes së instruksioneve në drejtim të mbështetjes së mësimëve islame, integrimin pozitiv. Së këtejmi, mbështetja ideore që gjen integrimi në traditën profetike, paraqitet si veçori e parë dhe substanciale e mbështetjes së proceseve integruese për bashkësinë muslimane në botëkuptimin islam.

Në këtë drejtim trajtohet edhe Karta e Medines si rast i veçantë i traditës profetike në mbështetjen e proceseve integruese, dhe një nga dokumentet religjioze më të vjetra në botë me karakter politik, që reflekton drejtpërdrejt në sferën e integrimit.

**Fjalët kyçe:** Religjioni, funksionet e religjionit, Integrimi, Islami, Tradita Profetike, Karta e Medines.

### 1. Domethënia e nocionit “integrim”

Shekulli njëzet hapi një kapitull të ri, i cili u shndërrua në karakteristikë më e dalluar e demokracisë dhe vlerave evropiane, gjegjësisht kapitullin e integrimi evropiane, i cili e promovon Evropën si model më të suksesshëm referent të demokracisë së vërtetë, kapitull ky që u motivua nga vetëdija për unitet dhe solidaritet, me qëllim që të realizohen interesa të përbashkëta në fusha të ndryshme. Shembulli i Unionit Evropian, si një shembull praktik i integrimi evropiane, ka qenë inspirim për forcimin e bashkëpunimit të shumë shteteve tjera jo evropiane dhe e ka pasur ndikimin e vet edhe në kontinente tjera. Kështu, sipas shembullit të UE, u formua organizata NAFTA në Amerikën Veriore, ASEAN në Azinë Juglindore, Unionit Afrikan në Afrikë, etj.

Bota sot çdo ditë e më tepër lëviz drejt integrimit, dhe integrimi paraqet objektiv strategjik të shteteve dhe shoqërive bashkëkohore, dhe duket se fjala “integrim” është një nga nocionet më të përdorura në vokabularin social, ekonomik dhe politik.

Mirëpo, për t’u futur në analiza të mëtutjeshme të ndikimit të mësimave religjioze islame në proceset integruese të bashkësisë muslimane në perëndim, duhet sqaruar domethënien e nocionit “integrim”, i cili është edhe nocioni më i përdorur në këtë qasje.

Për integrimin janë dhënë përkufizime të ndryshme, por, sipas një përkufizimi më të thjeshtë, integrimi paraqet lidhje institucionale në mes dy e më tepër bashkësive në një shoqëri. Sipas Majkel

Hoxhis (Michael Hodges), integrimi është “formimi i sistemeve të reja politike nga ato që deri tash kanë qenë të ndara” (Hodges, 1972: 13). Sipas Talcott Parsons (Talcott Parsons), funksioni i integritit është që të mban gjendje të baraspeshës së brendshme dhe t’i eliminojë konfliktet në mes pjesëve të një sistemi (Parsons, 1961: 40). Sido që të definohet nocioni integrim, është parimisht e pranuar se integrimi ngrihet mbi parimin e vënies së lidhjeve më të ngushta kulturore, politike dhe ekonomike mes shteteve. Në dritë të këtij parimi, integrimet evropiane nënkuptojnë “ngritje të unitetit mes shteteve dhe popujve evropianë”. Në UE, ky nocion nënkupton bashkimin e resurseve nacionale të shteteve, dhe marrjen e një sërë vendimesh të përbashkëta (Bojçev, 2007: 79).

### 1.1. Integrimi dhe asimilimi

Kur bëhet fjalë për integrimin, mendohet për një proces i cili krijon ndjenjë të veprimit aktiv në rrethin ku jeton dhe vepron personi, afrimin me njerëzit të cilët jetojnë në të njëjtin rreth ku jeton personi përkatës, si dhe disponimin që me ta të bashkëjetohe duke i perceptuar dallimet e tyre. Me këtë, integrimi mëton që personi të orientohet në drejtimin e perceptimit të personave dhe grupeve të cilat kanë identitet të ndryshëm, pa mos ndodhur shkrirje të këtyre grupeve, por duke ndodhur ndikim i ndërsjellë. Kjo do të thotë se integrimi nuk është asimilim, gjegjësisht asimilimi është proces i kundërt me integrimin. Sipas Gani Bonit, integrimi nuk nënkupton shkrirje ose bashkim të pjesëve për të formuar një pjesë më të madhe, por integrimi nënkupton proces të krijimit të një kuadri të përbashkët, proces të vënies së raportit mes pjesëve, me çka pjesët nuk suprimohen, por në tërësi plotësohen (Боби, 2008: 9).

Këtë e theksojnë edhe shumë personalitete politike evropiane. Kështu, Jürgen Ritgers (Jürgen Rüttgers), kryetar i Rajos Veriore-Vestfalisë (North Rhine-Westphalia), thotë: “Integrimi nuk është asimilim. Ju nuk duhet ta leni religjionin tuaj, por ju duhet t’i ndiqni vlerat tona themelore” (cituar në: Caldwell, 2009: 125). Rita Verdonk (Rita Verdonk), ish-ministre gjermane e imigracionit, thekson se

“integrimi nuk është asimilim, dhe se Gjermania është përcaktuar për integrim të emigrantëve, e jo për asimilimin e tyre...Politika e Gjermanisë është se emigrantët patjetër ta mësojnë gjuhën gjermane, t’i ndjekin normat dhe vlerat gjermane dhe ta respektojnë ligjin” (cituar në: Caldwell, 2009: 125).

Asimilimi definohet si “proces gjatë të cilit një dukuri shoqërore (proces, grup) në kontakt me dukuri tjetër të të njëjtit lloj, i humb veçoritë e veta, humbet dhe shkrihet në dukurinë tjetër” (Vidanovič, 2006: 1).

Sipas Jingerit, (Milton Yinger) “asimilimi është proces i pakësimit, i cili mund të ndodh gjatë takimit të anëtarëve të dy apo më tepër bashkësive, grupeve etnike, apo grupeve më të vogla sociale” (Yinger, 1994: 39).

Robert E. Park (Robert Ezra Park) dhe Milton Gordon (Milton Gordon), janë dy autorë të cilët kanë bërë analiza të gjëra përkitazi me ciklet e asimilimit. Kështu, sipas Robert A. Park “procesi i asimilimit kalon nëpër katër faza themelore, edhe atë: faza e parë është kontakti si rezultat i imigracionit; pastaj, në fazën e dytë kalon në konkurrencë, e cila shpesh shoqërohet edhe me konflikte; si rezultat i konkurrencës mes grupeve, pason akomodimi i cili në fund çon në asimilim” (cituar në: Živkovič dhe tjerë, 1998: 27).

Nga ana tjetër, një teori më fleksibile e cikleve të asimilimit, është ajo e Milton Gordonit. Gordon, identifikon shtatë lloje apo shkallë të asimilimit. Këto janë shkallët vijuese: akulturimi-që nënkupton pranim të disa forma themelore kulturore të shoqërisë së imigracionit; asimilim struktural- i cili nënkupton futje në klube, grupe, shoqëri dhe institucione, si dhe kontakte në nivel të grupeve primare; amalgamacioni- që do të thotë martesë të ndërsjella; asimilim identifikues- që nënkupton zhvillim të identitetit të përkatësisë ndaj shoqërisë së imigrimit; mosprezenca e paragjykimit; mosdiskriminimi; dhe mos ekzistimi i konfliktit të vlerave dhe fuqisë (Gordon, 1964: 71).

Në Evropë, hasen dy modele të integritimit:

1) Modeli anglez: Ky model është më multikulturor, për shkak se pranon që një person t'i përmbahet një kulture të ndryshme nga ajo e vendit, nëse i respekton ligjet e vendit (Roy, 2004: 66; Caldwell, 2009: 123 ).

2) Modeli francez: Ky model e promovon integrimin përmes asimilimit. Modeli francez konsiston në atë që emigrantët duhet të jenë francezë në lojalitetin e tyre kulturor (Caldwell, Ibidem). Ky model ndërtohet mbi parimet laike të shekullarizmit dhe asimilimit. Ky model beson në shoqëri homogjene, ndërkaq e përjashton multikulturalizmin (Laqueur, 2009: 50).

Modeli më i përshtatshëm për shoqëritë multikulturore, kur janë në pyetje bashkësitë fetare, është modeli i integritit e jo modeli i asimilimit. Integrimi paraqet pasuri kulturore për shoqërinë multikulturore, ngase ndryshe është rëndë të jetë, për shkak se mjetet e komunikimit bashkëkohor i afrojnë anëtarët e një bashkësie. Po ashtu, modeli i integritit është tregues se respektohen të gjitha kulturat, bile edhe kur janë në pyetje bashkësitë që janë pakicë. Kjo kontribuon për përfitimin e lojalitetit të pjesëtarëve të bashkësive pakicë dhe për nxitjen e tyre për participim të gjerë në shoqëri. Kësaj i shtohet edhe fakti se në shoqëritë multikulturore, e ndryshme nuk mund të neglizhohet dhe as të zhduket plotësisht nga realiteti. Nga ana tjetër, asimilimi si model për shoqëritë multikulturore, nuk është model adekuat, ngase njerëzit nuk janë të gatshëm të heqin dorë prej kulturave të tyre të cilat janë të ngulitura thellë në jetën e tyre, e shumë prej tyre janë të lidhura ngushtë me religjionin. Po ashtu, siç shënon edhe Bikhu Parek (Bikhu Parekh), në modelin asimilues, zgjedhja e pakicave është e thjeshtë. Nëse duan të bëhen pjesë e shoqërisë dhe të jenë të barabartë me qytetarët e tjerë, ata duhet të asimilohen (Parekh, 2000: 197).

Në shoqëritë e sotme multikulturore, integrimi tregohet si model adekuat. Kështu, në shoqëritë perëndimore, nuk ka ndodhur asimilimi i muslimanëve dhe konvertimi i identitetit fetar të bashkësisë muslimane, por bashkësitë perëndimore krishtere u akomoduan me realitetet e reja, gjegjësisht ata u akomoduan me xhamitë, femrat

e veshura sipas rregullave islame në vendet publike dhe festat fetare të muslimanëve. Ndërkaq, në disa vende, fjala vjen në Mbretërinë e Bashkuar, lagje të tëra janë të banuara me muslimanë, ndërkaq në Gjermani dhe në Francë, janë të njohura pazaret e turqve dhe marokenëve, gjegjësisht muslimanëve. Në lidhje me integrimin si model adekuat të shoqërive multikulturore, Vil Kimlika (Will Kymlicka), thotë: “Duke filluar nga vitet 70-ta të shekullit XX, nën presion të grupeve imigrante, të tre vendet (SHBA-të, Kanada dhe Australia), e hodhën modelin asimilues dhe pranuan një politikë më tolerante, e cila u lejon dhe i nxit imigrantët t’i ruajnë aspektet e ndryshme të trashëgimisë së tyre etnike. Sot është e pranuar në masë të gjerë (edhe pse jo unanimisht), se imigrantët duhet të jenë të lirë t’i ruajnë disa nga traditat e tyre të vjetra në lidhje me ushqimin, veshjen, religjionin, dhe të shoqërohen mes veti që t’i ruajnë ato praktika” (Kimlika, 2004: 30-31).

## 2. Definimi i Religjionit

Fjala religjion rrjedh nga fjala latine “religiare” që do të thotë “të lidhesh” që konsiderohet si një lidhje e komunitetit të caktuar shoqëror të klanit, fisit, individit me një qenie mbinatyrore.

Definimi i religjionit është njëri nga problemet kyçe të Sociologjisë së Religjionit, për atë, rastisim definicione të ndryshme të religjionit, varësisht prej këndit nga i cili e ka parë religjionin ai i cili e ka dhënë një definicion të caktuar për religjionin. “Edhe përkaj tentimeve për disa vite me radhë, në qarqet shkencore nuk është arritur një pajtim i qartë në lidhje me definimin e fenomenit religjion” (Свидлер и Мојзел, 2005: 11).

Teologët e definojnë religjionin duke i nisur prej parimit bazë se religjioni është i shpallur prej Zotit. Sipas tyre, religjioni është shpallje e Zotit, ligj hyjnor për të mirën e njeriut në këtë botë dhe në botën tjetër (Draz, 30).

Për dallim prej teologëve, sociologët dhe antropologët e shohin ndryshe religjionin, dhe definicionet e tyre janë shprehje e qasjes shkencore laike ndaj fenomeneve, në këtë rast ndaj fenomenit religjion, të liruar prej parimeve religjioze. Megjithatë, as definicionet e sociologëve dhe antropologëve nuk kanë qenë immune nga ndikimi i drejtimit filozofik, ithtarë i të cilit ka qenë autori i definicionit në fjalë. Për këtë shkak kemi definicione të shumta për religjionin, definicione këto që dallojnë mes veti në masë të madhe. Në këtë kontekst, Malkom Hamilton (Malcom Hamilton), thotë: “Kur bëhet fjalë për tentimet që të definohet religjioni, nuk duhet harruar se këto definicione nuk janë të liruara çdo herë nga ndikimi i animeve dhe objektivave teorike. Me fjalë tjera, atë që e mendojnë teoricienët se është religjion, shpesh varet prej mënyrës së sqarimit nga e cila ata anojnë” (Hamilton, 2003: 31). Nisur nga kjo, disa sociologë refuzojnë të japin definicione për religjionin në fillim të gjurmimeve të tyre për religjionin, por, sipas tyre, kjo mund të bëhet pas gjurmimeve të detajuara (Hamilton, *Ibidem*, 29). Kështu, antropologu Nejdal në studimin e tyre për besimet religjioze dhe praktikën fetare të një populli afrikano-verior, thotë se “çdo definicion i religjionit, do të mbajë në vetvete një dozë të pa sigurisë” (cituar në: Hamilton, 2003: 31).

Definicionet të cilat janë dhënë për religjionin dallojnë mes veti për atë se disa e kanë definuar religjionin duke nisur nga esenca e religjionit, gjegjësisht duke u nisur nga komponenti themelor në formimin e religjiozes si fenomen i veçantë shoqëror, e që është ideja për qenien mbinatyrore (Ацески, 2007: 298), ndërkaq disa tjerë, e kanë definuar religjionin sipas funksionin të cilin e kryen religjioni në shoqëri. Për çdo një definicion mund të jepen vërejte, por, ne këtu nuk kemi për qëllim të debatojmë rreth definicioneve të religjionit, për atë, nuk do të ndalemi në këto debate. Ne do të përmendim definicione të religjionit, sa për ilustrim.

Kështu, për Fojerbahun (Ludwig Feuerbach), religjioni përbëhet prej ideve dhe vlerave të krijuara nga qeniet njerëzore gjatë zhvillimit të tyre kulturor. Por, këto ide janë të përfaqësuara në mënyrë të gabuar në forcat dhe hyjnitë mbi natyrore (Feuerbach, 1955: 56).



Sociologu amerikan Milton Jinger (John Milton Yinger), e definon religjionin si sistem besimesh dhe praktikash fetare, përmes të cilave një grup njerëzish lufton me problemet qenësore të jetës njerëzore (Yinger, 1994: 256).

### 2.1. Koncepti islam për religjionin

Kur bëhet fjalë për integrimin e komunitetit musliman në UE, nuk mund të mos përmendet koncepti islam për religjionin, si bazë mbi të cilën komuniteti musliman i ndërton botëkuptimet e veta. Patjetër të kihet një pasqyrë për mësimin islam për religjionin, për atë se ky mësim ka implikacione në qëndrimin e muslimanëve për integrimin në përgjithësi, dhe për integrimin politik në veçanti.

Sipas Islamit, religjioni nuk është vetëm lidhje ndërmjet njeriut dhe Krijuesit në kuptimin spiritual dhe vetëm në suaza të tempujve fetarë, por religjioni nënkupton lidhje në mes Krijuesit dhe krijesave, dhe në mes vetë krijesave dhe botës rreth tyre. Sipas Islamit, religjioni nuk e rregullon vetëm raportin e njeriut ndaj Zotit në aspektin shpirtëror, por, religjioni e rregullon raportin e njeriut ndaj jetës në aspektin shpirtëror, shoqëror, ekonomik, politik, moral dhe material. Sipas Islamit, religjioni ka parime të përgjithshme të cilat i rregullojnë të gjitha çështjet jetësore, qofshin të karakterit shpirtëror, ekonomik, politik, moral, etj. Parimet e përgjithshme të cilat i ka Islami si fe, ia mundësojnë që të përballet me të gjitha problemet bashkëkohore dhe të ofrojë zgjidhje adekuate për to (Ramadan, 1999: 4; Fuller, 2010: 22).

Koncepti i këtillë islam për religjionin, ka impakt në ndërtimin e qëndrimeve në lidhje me integrimin. Mbi konceptin e këtillë për religjionin, palë të caktuara në kampusin islam ndërtojnë qëndrim pozitiv ose negativ ndaj integritit të muslimanëve në UE. Kështu, që të ndërtohet qëndrim pozitiv ndaj integritit, nuk mjafton që të garantohet liria shpirtërore dhe e drejta e besimit, por kjo varet edhe nga mundësia e theksimit të përkatësisë fetare edhe në segmentet tjera të jetës, siç janë: ekonomia, politika, arsimit, ushqimi, puna, etj. Nëse të gjitha këto elemente nuk janë prezente për identitetin fetar

në një proces, kjo do të thotë se ky proces është negativ për muslimanin, dhe ai nuk duhet të jetë pjesë e atij procesi.

Një aspekt tjetër, i cili po ashtu duhet të kihet parasysh, kur është pyetje raporti i konceptit të religjionit me integrimin, është ai i kornizave të kuptimit të religjionit, gjegjësisht a kuptohet religjioni në rregulla dhe qëndrime të ngushta, apo religjioni kuptohet në dimensionin e tij universal, gjegjësisht si fenomen shoqëror, si kulturë, etikë, mënyrë komunikimi me tjerët, dhe si kuptim universal për shpirtin, materien, jetën dhe shoqërinë.

Ata të cilët e kuptojnë religjionin në këtë mënyrë, ndërtojnë qëndrim pozitiv për integrimin e muslimanëve në UE, për atë se bindja e tyre për përfshirjen e religjionit të gjitha sferat e jetës, nuk kufizohet vetëm në rregulla dhe dispozita juridike, por ata e shohin religjionin si fenomen shoqëror me dimension universal, i cili është fleksibil që të ofrojë zgjidhje për të gjitha problemet e mundshme të cilat dalin para komunitetit musliman në procesin e integritimit.

Trajtimi i religjionit si kulturë dhe civilizim, hap horizonte të gjëra për komunitetin musliman dhe mundësi për participim të përgjithshëm të muslimanëve në shoqëritë evropiane, siç ishte rast gjatë prezencës tetëqind vjeçare të muslimanëve në Spanjë. Muslimanët dhanë kontribut të çmuar dhe patën ndikim të theksuar në renesancën evropiane (Arnold, 1990: 161).

### 3. Roli i mësimi islam në proceset integruese

Kur trajtohet çështja e integritimit të muslimanëve në UE, nuk mund të tejkalohe ndikimi i fesë, gjegjësisht qëndrimi i burimeve bazë të Islamit: Kur'anit dhe Sunetit-praktikës profetike në lidhje me integrimin e komunitetit musliman në shoqëritë ku jetojnë, në këtë rast në UE. Kjo, ngase burime e Islamit dhe të mendimit politik islam, nuk janë jashtë ndikimit në proceset integruese, gjegjësisht përmbajnë një varg elementesh të cilat e vërtetojnë qëndrimin e Islamit

ndaj integritet të komunitetit musliman në shoqëritë ku jetojnë, e ku janë në numër më të vogël prej komuniteteve tjera në atë shoqëri.

Burimet bazë të Islamit, Kur'ani dhe Suneti, janë përplot fakte dhe dëshmi të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në nxitjen e integritetit e jo izolimit të komunitetit musliman në shoqëritë ku jetojnë. Por, ne me këtë rast, do ta kemi temë shqyrtimi burimin e dytë të Islamit: Sunetin, dhe do të thirrëmi në këtë burim për ta konstatuar rolin e mësimin islam në proceset integruese.

### 3.1. Definicioni i Sunetit-Traditës profetike

Në aspektin gjuhësor, fjala “es-sunne”, në gjuhën arabe ka kuptimin rrugë, pa marrë parasysh a bëhet fjalë për rrugë të mirë apo të keqe. Ndërkaq, në aspektin terminologjik islam, “es-Sunne” është përkufizuar si: “Çdo transmetim nga i Dërguari i Allahut si thënie, vepër apo miratim” (es-Sajis, 2013: 63). Të gjithë dijetarët islamë kanë arritur konsensus për atë se Suneti-tradita profetike, është burim i dytë autoritativ i të drejtës islame, dhe argumentet autentike të traditës profetike paraqesin pikë referuese për studiuesit gjatë eksplorimit të çështjeve të ndryshme nga këndvështrimi islam.

Tradita profetike në funksion të integritetit

Praktika e profetit Muhamed, paqja e Zotit qoftë mbi të, për të cilin profet muslimanët besojnë se është profet i fundit i dërguar prej Zotit, dhe për thëniet dhe praktikën e të cilit besojnë se janë burim i dytë konsensual i të drejtës islame, qartë udhëzon në mbështetjen e orientimit integrist. Këtë konstatim do ta ilustruon me dy shembuj nga fusha e traditës profetike:

- **Emigrimi i parë dhe i dytë në Abisini (Etiopi):** Para emigrimit të njohur në qytetin Medina, në vitin 622, dy grupe muslimanësh, me leje nga vetë profeti Muhamed, paqja e Zotit qoftë mbi të, emigruan për në Abisini (Etiopi), e cila atëbotë ishte mbretëri e cila sundohej nga një mbret i krishterë. Kjo do të thotë se vetë profeti Muhamed, paqja e Zotit qoftë mbi të, ka pranuar që këta muslimanë

të emigruar në Abisini të jetojnë në një shoqëri e cila dallon nga ata në aspektin e besimit. Normalisht, ata jetuan në atë shoqëri në mesin e një popullate krishtere, u integruan në rrjedhat shoqërore, u adaptuan me jetën në atë vend dhe punuan që ta sigurojnë ekzistencë e vetë në një ambient dhe shoqëri të tillë.

▪ **Formimi i shtetit islam në Medine:** Me formimin e shtetit të parë islam në Medine, nën udhëheqjen e profetit Muhamed, paqja e Zotit qoftë mbi të, u vunë themelet e bashkëjetesës me pjesëtarët e feve tjera dhe integritit të bashkësive me tradita të ndryshme kulturore në një shoqëri të përbashkët. Edhe pse në rastin në fjalë, muslimanët ishin shumicë, ndërkaq jo muslimanët pakicë, gjë që është e kundërt me gjendjen aktuale të komunitetit musliman në Evropë, i rëndësishëm është mesazhi të cilin e dha vetë profeti Muhamed, paqja e Zotit qoftë mbi të, e që është: Integrimi i pjesëtarëve të feve të ndryshme, në një shoqëri të përbashkët.

▪ **Karta e Medines:** “Sahifetu-l-Medine” apo “Karta e Medines”, është dokumenti i shkruar i cili i rregullonte marrëdhëniet e bashkësive të ndryshme në shtetin e porsaformuar islam në Medine, me rastin e shpërnguljes së muslimanëve prej Mekes në Medine, në vitin 622. Në këtë dokument, i cili konsiderohet kushtetutë e parë e shkruar e shtetit islam në Medine, pjesëtarët e religjioneve tjera trajtoheshin bashkë me muslimanët si qytetarë të shtetit islam, të cilët kanë të drejta dhe detyrime të caktuara. Ky hap i profetit Muhamed, paqja e Zotit qoftë mbi të, qartë tregon se dallimi në besim, nuk është pengesë për formimin e shoqërisë multikulturore, dhe as për jetë të përbashkët në një shoqëri.

Kjo që shënuam këtu nga fusha e Sunetit-Traditës profetike, përkitazi me promovimin e dialogut, bashkëpunimit në atë që është e dobishme dhe produktive, si dhe tolerancës, janë vetëm një pjesë e asaj që mund të thuhet për çështjen e integritit nga dioptria e Sunetit.

Me këtë rast, duhet pasur kujdes se shumë raporte janë ndërruar në suaza globale, dhe duhet të jemi të vëmendshëm ndaj interpretimeve të caktuara klasike të teksteve fetare, të cilat kanë qenë rezultat i kohës dhe rrethanave të atëhershme, e jo e një analize

të thellë dhe të gjithanshme shkencore. Së këtejmi, disa interpretime të teksteve fetare, të cilat kanë karakter izolues, dhe të cilat thërresin në largim dhe distancim prej shoqërive jo islame dhe nga çdo kontribut për të mirën e atyre shoqërive, duhet të kuptohen në kontekstin e tyre kohor, kur shteti islam ka qenë në luftë me shtetet jo islame, e jo në kontekst të kohës së sotme, kur ekzistojnë raporte tjera të vendeve muslimane me vendet jo muslimane, dhe kur në vendet perëndimore janë të garantuara të drejtat themelore njerëzore, pa marrë parasysh përkatësinë religjioze dhe etnike të qytetarëve. Po ashtu, këto interpretime duhet të kuptohen si interpretime dhe qëndrime personale përkitazi me tekstet përkatëse fetare, e jo si qëndrime dhe mesazhe të vetë teksteve.

Po ashtu, një çështje tjetër që duhet nënvizuar me këtë rast është edhe mënyra e qasjes që duhet bërë teksteve fetare, kur trajtohen relacionet musliman-jo musliman dhe musliman-shoqëri. Teksteve fetare, kur janë pyetje trajtohen relacionet musliman-jo musliman dhe musliman-shoqëri, duhet qasur nga karakteri i tyre universal i pa kushtëzuar nga koha, vendi dhe rrethanat. Qasja e këtillë do të gjenerojë qëndrim pozitiv të muslimanit ndaj shoqërisë dhe njerëzve, dhe të shihet Islami dhe mësimet e tij religjioze si mbështetës i integritetit të muslimanit në shoqërinë ku jeton, në mënyrë të drejtë dhe konstruktive.

### 3.2. Vlera integruese në kartën e medines

#### Çka paraqet “Karta e Medines”?

“Karta e Medines” është një dokument historik i cili është përpiluar nga ana e profetit Muhamed, paqja e Zotit qoftë mbi të, pas shpërnguljes së tij në Medine, me të cilin dokument rregulloheshin të drejtat dhe obligimet e bashkësive ekzistuese në Medine, në shtetin e ri, i cili udhëhiqej nga vetë profeti Muhamed, paqja e Zotit qoftë mbi të, si lider shpirtëror dhe politik. Me fjalë tjera, me shpërnguljen e profetit Muhamed, paqja e Zotit qoftë mbi të, dhe të muslimanëve nga Meka në Medine, në Medine u formuan tri bashkësi të mëdha: Ensarët-banorët arabë të Medines, vendasit, të cilët

kaluan në Islam; Muhaxhirët- muslimanët e Mekes të cilët u shpërngulën në Medine; Hebrejtë të cilët jetonin në Medine, dhe të cilët përbëheshin nga disa fise. Ky dokument mund të pranohet si dëshmi për gjendjen politike në Medine, pas ardhjes së profetit Muhamed, pagja e Zotit qoftë mbi të (Watt, 1989: 93).

Karta e Medines-Es-sahife, është një dokument i rëndësishëm fetar dhe politik i cili flet për mënyrën si i ka integruar i Dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], bashkësitë e ndryshme në shtetin dhe shoqërinë e re, pa mos u përjashtuar asnjëra bashkësi nga jeta politike dhe nga rrjedhat shoqërore. Kështu, në shtetin e Medines u ndërtua një shoqëri multietnike dhe multikonfesionale me një dokument juridiko-politik i cili është i njohur edhe si “Kushtetuta e Medines” (Ibidem, 93), i cili u jepte përparësi specifike fetare, juridike dhe kulturore, dhe e përmbante modelin pluralist të shoqërisë. Këtë pluralizëm e vente nën garanci kushtetuese (Bulaç, 1998: 31).

Sipas “Kartës së Medines”, të gjitha bashkësitë në Medine janë element konstitutiv i shoqërisë, i kanë të gjitha të drejtat dhe obligimet që u takojnë, gjegjësisht, kjo kartë, për të gjitha bashkësitë në Medine e vuri në funksion kategorinë “umma” shtetas, e cila mund të krahasohet me nocionin “nation”.

Në fillim të Kartës së Medines flitet për themelimin e bashkësisë muslimane, e cila është edhe bashkësi fetare edhe politike, dhe përbëhet prej muslimanëve të cilët u shpërngulën prej Meke, prej muslimanëve vendas të Medines, si dhe prej atyre muslimanëve të cilët e pranuan pushtetin e tillë dhe detyrën që të luftojnë bashkë me muslimanët në rast lufte (Hamidullah, 1990:I, 176). Në pjesën hyrëse (preambulën) të Kartës së Medines, në mënyrë taksative thuhet: “Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirbërësit. Ky është dokument i profetit Muhamed, dhe u referohet besimtarëve të fisit Kurejsh dhe Jethribi, si dhe të gjithë tjerëve të cilët ishin pjesë e kësaj marrëveshje dhe bashkërisht luftojnë” (Ibn Hişam, 1998: 106). Kështu, të gjithë anëtarët dhe të gjitha bashkësitë në Medine, nënshkruar të Kartës, konsiderohen një “umma” ose “nation”, megjithatë, çdo bashkësi është bashkësi e veçantë juridike me autonomi fetare dhe kulturore (Bulaç, 1998: 23).

Në drejtim të integritit të bashkësive, Karta e Medines i garanton edhe të drejtat fetare, ndërkaq integrimi i një bashkësive nuk mund të mendohet pa garantimin e të drejtave fetare. Kështu, në Kartën e Medines në mënyrë taksative thuhet: “Hebrenjtë le ta ndjekin fenë e vet, e muslimanët fenë e vet, si dhe le t’i mbrojnë mbrojtësit dhe jetët e tyre” (Ibn Hişam, 1998: 108).

Sipas Kartës së Medines, si legjislaturë e parë me të cilën u rregulluan marrëdhëniet e të gjitha bashkësive në shtetin e ri të formuar në Medine, bashkësia hebreje pakicë ishte e integruar edhe në segmentin e sigurisë, si një nga segmentet më të ndjeshme të shtetit. Kjo ishte e theksuar në mënyrë eksplicite në vetë nenet e Kartës së Medines, dhe disa nene të këtij dokumenti i referohen aspektit të sigurisë së shtetit, gjegjësisht rolit të bashkësive në hartimin e politikës së sigurisë në shtetin musliman të Medines. Për shembull, në njërin nga nenet e kësaj Karte, thuhet: “Hebrenjtë dhe muslimanët le të ndihmohen mes veti kundër çdo kujt që do ta sulmojë Jethribin”. (Ibidem, 108).

Në një nen tjetër thuhet: a) Hebrenjtë do t’i mbulojnë harxhimet e veta, ndërkaq muslimanët të vetat. Le të ndihmohen mes vete në luftë kundër armiqve të kësaj Karte. Le të kalitin marrëdhënie të mira dhe le të mbretëroj paqja mes tyre. Le t’i përmbahen kësaj Karte dhe mos ta thyejnë; b) Mos e dëmtoni aleatin tuaj, dhe ndihmoni të shtypurit (Ibidem, 108).

Në këtë kontekst, Karta e Medines i obligon të gjitha bashkësitë që ekzistojnë në Medine, muslimanë dhe jomuslimanë, që t’i mbajnë harxhimet e luftërave mbrojtëse. Kjo qartë është e theksuar në dy pika të Kartës së Medines.

E karakterit të sigurisë është edhe ajo se muslimanëve u ndalohej që t’u ndihmojnë armiqve të hebrenjve të cilët janë në marrëveshje me muslimanët. Po ashtu, e këtij karakteri ishte edhe marrëveshja që të trajtohen njëjtë si bashkësia hebreje, edhe ata me të cilët bashkësia hebreje ka lidhur marrëveshje për mbrojtje dhe paqe (Kureshi, 2004: 73).

Kjo Kartë flet për kapacitetin integrues të bashkësisë muslimane, për atë se e porosit modelin e hapur për participim të plotë politik të grupimeve të ndryshme fetare, kulturore dhe etnike (Bulaç, 1998: 42), si dhe për fuqinë integruese të burimeve të fesë islame. Kjo dëshmohet nga fakti se ai i cili e ka realizuar procesin integrues në shtetin e posaformuar në Medinë, ka qenë vetë profeti Muhamed, pagja e Zotit qoftë mbi të. Edhe pse në këtë rast kemi të bëjmë me shumicë muslimane, dhe pikërisht kjo shumicë ishte bartëse e procesit integrues, poenta qëndron në atë që muslimanët, qofshin shumicë apo pakicë, mund të jetojnë me tjerët dhe të jenë kreativ në shoqëritë në të cilat jetojnë, e jo të izoloohen prej tjerëve.

Karta e Medines është dokument i rëndësishëm fetar dhe politik i cili shkon në favor të rrymës e cila e mbështet integrimin, dhe është dëshmi e cila nuk u ndihmon mbështetësve të izolimit të muslimanëve nga shoqëria shumicë jomuslimane, në të cilën jetojnë. Ajo që muslimanët në shoqërinë medinase kanë qenë shumicë dhe faktor vendimmarrës, ndërkaq në shoqëritë e sotme evropiane janë pakicë pa fuqi për të vendosur, nuk qëndron si argument për rrymën izolacioniste, për shkak se edhe atëherë do të veprohej sipas logjikës së getoizimit të bashkësive, nëse në Islam nuk kishte vlera integruese.

Për sa i përket fuqisë për të vendosur, ne besojmë fuqishëm se integrimi do t'i jep bashkësisë muslimane fuqi politike, në suaza të sistemit demokratik.

## PËRFUNDIM

Nga ajo që u tha në këtë punim në lidhje me rolin e religjionit në integrim, vërtetohet teza e këtij punimi se tradita profetike, si burim i dytë autoritativ i Islamit dhe i pranuar një zërit nga ana e dijetarëve, me qasjen që ia bën raportit të muslimanit ndaj të ndryshmit dhe dialogut me tjerët, ndikon pozitivisht në integrimin e muslimanëve në shoqëritë ku jetojnë, në këtë rast, në UE.



Integrimi paraqet element thelbësor të të gjitha segmenteve të jetës në një shoqëri, të marrëdhënieve të shoqërive njerëzore mes veti, si dhe të rendit të ri botëror. Kjo është e qartë kur kihet parasysh fakti se proceset integruese paraqesin objektiv strategjik të organizatave të ndryshme ndërkombëtare dhe të politikave qeveritare gati në të gjitha shtetet e botës. Sot, bota gjithnjë e më tepër integrohet dhe nuk është e mundur të ketë zhvillim në një shoqëri dhe në një shtet, nëse neglizhohen proceset integruese si objektiv strategjik i politikave të zhvillimit në atë shoqëri dhe në atë shtet.

Integrimi dallon prej asimilimit. Kur përmenden nocionet “integrim” dhe “asimilim”, mendohet në procese dy procese të kundërta. Gjatë asimilimit, një grup, në kontakt me grupin tjetër, i humb veçoritë e veta dhe shkrihet në grupin tjetër. Nga ana tjetër, gjatë integrimit, një grup, në kontakt me grupin tjetër, nuk i humb veçoritë e veta dhe nuk shkrihet në grupin tjetër, por në këtë rast, kemi pranim të grupeve apo individëve tjerë me identitet të ndryshëm, kemi ndikim të ndërsjellë të grupeve, por jo edhe asimilim të një grupi në grupin tjetër.

Përzierja e këtyre dy nocioneve, ka qenë shkak i lindjes së kundërthënieve brenda vetë bashkësisë muslimane, përkitazi me integrimin e muslimanëve me UE. Kjo dhe disa rryma brenda proveniencës islame, integrimin e muslimanëve e shohin si fillim të asimilimit të tyre. Për ta nuk mund të merret me mend që një bashkësi të futet në procesin e integrimit, pa mos përfunduar me asimilim, ngase nuk mund të flitet për integrim, pa mos u bërë lëshime në disa elemente të cilat janë të lidhura për identitetin. Qasja e këtillë gjeneroi promovimin e një politikë izoluese për bashkësinë muslimane nga ana e tyre, me pretekst se politika e këtillë izoluese është garanci për mbrojtjen e identitetit të bashkësisë muslimane. Megjithatë, pjesa dërrmuese e mendimtarëve muslimanë dhe rrymat moderne brenda bashkësisë muslimane, në veçanti ata të cilët jetojnë në Evropë, ose të cilët merren me problemet e muslimanëve në perëndim, mbajnë qëndrim tjetër. Sot, në të gjitha qarqet fetare, forumet, akademitë dhe institucionet tjera të muslimanëve evropianë, flitet për një

strategji dhe politikë aktive integruese të muslimanëve, përmes një edukimi të vërtetë fetar dhe politik të bashkësisë muslimane, me çka do të mbyllen rrugët për strukturat të cilët mbajnë qëndrime më të ashpra, dhe të cilët mundohen që në emër të religjionit të imponojnë një tempo tjetër për bashkësinë muslimane.

Në Evropë, kryesisht hasen dy modele të integrimit: 1. Modeli anglez, i cili është më multikulturor; dhe 2. Modeli francez, i cili e promovon integrimin përmes asimilimit. Modeli më i përshtatshëm për shoqëritë multikulturore, kur janë në pyetje bashkësitë fetare, është modeli i integrimit e jo modeli i asimilimit.

Bashkësia muslimane është e vetëdijshme se, për të marrë pjesë në institucionet e Unionit Evropian dhe në jetën publike në përgjithësi në Evropë, duhet të integrohet në shoqëri. Unioni Evropian, i cili nuk është vetëm Union i shteteve, por edhe i qytetarëve, është i përcaktuar qartë për mbrojtjen dhe afirmimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe të drejtave të pakicave. Kjo u mundëson të gjitha bashkësive, përfshi këtu edhe ato bashkësi që konsiderohen pakicë, siç është bashkësia muslimane në Evropën Perëndimore, qasje adekuate në jetën dhe në proceset politike të Unionit. Në këtë drejtim janë nënshkruar disa dokumente dhe marrëveshje për të drejtat politike dhe religjioze të pakicave.

Integrimi është një proces në rrjedhë e sipër, dhe varet sa do të e suksesshme bashkësia muslimane që të inkuadrohet aktivisht në rrjedhat integruese. Tradita politike demokratike e UE-së dhe ligjet liberale në planin politik, kërkojnë prej bashkësisë muslimane inkuadrim më aktiv në proceset integruese të UE-së.

Për integrimin e muslimanëve në UE, në veçanti, dhe për integrimin si proces në përgjithësi, nuk mund të arrihet në rezultate autentike pa u analizuar ndikimi i religjionit, gjegjësisht qëndrimet e burimeve bazë të mësimit Islam: Kur'anit dhe Sunetit-traditës profetike, përkitazi me integrimin e muslimanëve në shoqëritë ku jetojnë, në këtë rast në vendet e UE-së. Këto burime bazë, në rastin konkret që trajton ky punim, Tradita Profetike-Suneti, përmbajnë elemente të

shumta të cilat e vërtetojnë qëndrimin pozitiv të Islamit ndaj integrimit të bashkësisë muslimane në shoqëritë ku ata janë më pak në numër.

## CONCLUSION

From the information presented in this research in connection with the term integration, i.e. the contribution of religion in terms of integration, confirms the general thesis of this study that: Islam and its ideological framework for the attitude towards the diverse persons and the dialogue with the others, has a positive influence in the integration of Muslim community in EU in general.

Integration is a key element in all segments of life in a society, in the attitude of human societies towards each other, as well as the new world order. It is obvious when we consider that the integration processes represent strategic goal of different international organizations and government policies in almost all countries of the world. The world today becomes more and more integrated and it is not possible to for a society and a country to become developed, if integration processes are not to be considered a strategic goal of development policies of that society and that country.

Integration is not assimilation. When we mention the terms integration and assimilation, we have in mind two different processes. During assimilation, one group in contact with the other, loses its characteristics and merges with the other group. On the other hand, during the integration, one group in contact with the other group doesn't lose its characteristics and doesn't merge with the other group, but we have an acceptance of other groups or individuals with different identities, we have a mutual influence of groups, but not an assimilation of one group by another.

Confusing of these two terms was the cause of opposing views on the integration of Muslims in EU, and inside the Muslim community itself. Thus, some Muslim movements see the integration as a prelude to assimilation of community. It is unimaginable to them

to approach to the integration process, without ending in assimilation, because we cannot talk of integration without stepping away of some elements connected the identity. It is the reason why they pursued an isolation policy for the Muslim community and they see in it a guarantee to preserve its identity. But, the majority of Muslim scholars and modern movements among the Muslim community, especially those living in Europe, are dealing with the problems of Muslim communities in the West and they have different attitudes. Today, in all religious circles, forums, academies and other institutions of European Muslims, it is discussed about intensive political integration strategy of the community, through a real religious and political education of community, thus closing the paths for extremist structures, who in the name of religion insist to impose other tempo for Muslim communities.

In Europe in general, there are two models of integration: 1) English model, which is a more multicultural and 2) French model, which calls for integration via assimilation. The best model for multicultural societies, when it comes to religious communities, is the model of integration, not the model of assimilation.

The Muslim community is aware that, in order to participate in institutions of the Union and in public life in general, in Europe, it must integrate into society. For its affirmation in Europe in general and EU countries in particular, the political integration is of big importance. The European Union, which is not only a union of countries, but also of citizens, is determined to protect and promote the human rights and freedom, and the rights of minorities. It allows all communities, including those considered minorities, such as the Muslim community, an appropriate access to political life and process of the Union. In this regard are signed several documents and agreements for the political and religious rights of minorities. The integration is a continuous process and depends a lot on the approach of the Muslim community towards integration tendency. The democratic political tradition of EU and liberal laws, require from

the Muslim community a more active approach toward EU integration processes, especially in the political sphere.

For the integration of Muslims in EU, in particular, and the integration in general, it is not possible for us to come to reliable results without analyzing the influence of religion, respectively the main source of Islamic teachings-the Koran and the messenger's practices-the Sunnah, related to the integration of the Muslim community in societies where they live, in this case, the EU countries. These sources contain several elements which confirm the positive attitude of Islam toward the Muslim community in societies where they are minorities.

## LITERATURA

Bulaç, Ali. 2005. *Koncepte dhe sisteme bashkëkohore*. Shkup: Logos-a.

Caldwell, Christopher. 2009. *Reflections on the Revolution in Europe*. London: Penguin Books Ltd.

Couvreur, Gilles. 1998. *Musulmans de France: diversité, mutations et perspectives de l'islam Français*. Paris: Ed de l'Atelier.

Cvitkovič, Ivan. 2007. *Socijalna naučavanja u religijama*. Sarajevo: Nacionalna i univerzitetska biblioteka Bosne i Hercegovine.

Draz, Abdullah. (Pa vit botimi). *Din ve Allah Inancı*. Istanbul: Bir yayıncılık.

Durkheim, Emile. 2000. *Format Elementare të Jetës Fetare*. Tiranë: Korbi.

Durousset, Maurice. 2004. *Bashkimi Evropian në shekullin XXI*. Shkup: Logos-a.

El-Eshkar, Sulejman. 2005. *Historia e Fikhut*. Shkup: Nun.

Fetzer, Joel S. и J.Christopher Soper. 2005. *Muslims and the State in Britain, France, and Germany*. New York: Cambridge University Press.

- Fuller, Graham E. 2010. *Islami politik e ardhmja e tij*. Tiranë: Arbëria.
- Giddens, Anthony. 2004. *Sociologjia*. Tirana: Çabej.
- Giddens, Anthony. 2013. *Pasojat e modernitetit*. Tirana: UET Press.
- Hamidullah, Muhamed. 1990. *Muhammed a.s. Život i dijelo*. Sarajevo: El-Kalem.
- Hamilton, Malkom. 2003. *Sociologjia religije*. Beograd: Clio.
- Heywood, Andrew. 2008. *Politika*. Prishtinë: Brezi '81.
- Ibn Hišam, Abdulmalik. 1998. *Poslanikov životopis*. Sarajevo: Bemust.
- Hodges, Michael. (ed). 1972. *‘Introduktion’, in European Integration*. London: Penguin.
- Ibrahimi, Arta. 2009. *Integrimi i Ballkanit Perëndimor në UE*. Shkup: Logos-A.
- Kardavi, Jusuf. 2005. *Mesazhi ynë në epokën e globalizimit*. Shkup: Furkan ISM.
- Laqueur, Walter. 2007. *The Last Days of Europe*. New York: St.Martin's Press.
- Lewis, Philip. 1994. *Islamic Britain: Religion, Politics and Identity among British Muslims*. London: Taurus.
- Mcguire, Meredith B. 2007. *Religjioni: konteksti shoqëror*. Shkup: Logos-A.
- Mesić, Milan. 2006. *Multikulturalizam*. Zagreb: školska knjiga.
- Parekh, Bhikhu. 2000. *Rethinking Multiculturalism: Cultural Diversity and Political Theory*. Cambridge, Massachusetts: Harvard University Press.
- Pavičević, Vuko. 1988. *Sociologjia Religije*. Beograd: Beogradski izdavačko-grafički zavod.
- Ramadan, Tariq. 2003. *Western Muslims and the Future of Islam*. Oxford University Press.
- Ramadan, Tariq. 1999a. *Muslims in France: The Way Towards Coexistence*. Leicester, UK: Islamic Foundation.

- Ramadan, Tariq. 1999. *To be a European Muslim*. Leicester: The Islamic Foundation.
- Reka, Blerim dhe Ibrahim, Arta. 2004. *Studime evropiane*. Тетово: ЈИЕ Универзитет.
- Roy, Olivier. 2004. *Globalizimi i Islamit*. Tiranë: IDK.
- Vidanovič, Ivan. *Rečnik socijalnog rada*. Во: <http://sr.wikipedia.org/sr-el/>
- Watt, W.Montgomery. 1989. *Muhamed prorok i državnik*. Sarajevo: Svjetlost.

#### ЛИТЕРАТУРА (КИРИЛИЦА)

- Боби, Гани. 2001. *Културен парадокс*. Скопје: Магор.
- Бојчев, Душан. 2007. *Европска Унија Лексикон*. Скопје: МИ-АН.
- Кимлика, Вил. 2004. *Мултикултурно граѓанство*. Скопје: Институт за демократија, солидарност и цивилно општество.
- Маршал, Гордон. 2004. *Оксфордски речник по социологија*. Скопје: МИ-АН.
- Миќуновиќ, Љубо. 1999. *Современ Лексикон на странски зборови и изрази*. Штип: Венеција.
- Свидлер, Леонард и Мојзес, Пол. 2005. *Изучувањето на религијата во ерата на глобалниот дијалог*. Скопје: Темплум.